



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkise, Mbiqyrjes Financiare, I Ekonomise Vendore, Turzimit dhe Zhvillimit Rural.

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin European

Raport vendimmarrjeje

Nr 6 /Datë 28.01 2026

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË FAMILJEVE NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDIN DERI NË 6% NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE PËR VITIN 2026, shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet perkatese.

Analiza ligjore:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1, shkronja (a) dhe (b), nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 21 të ligjit nr.57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr.597, datë 4.09.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", ndryshuar me Vendimin nr.855, datë 26.12.2024

Situata aktuale e funksionit:

Miratim për kriteret mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor, për vitin 2026.

Përfituesit nga fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike do të përzgjidhen nga familjet aplikuese për ndihmë ekonomike të cilat janë refuzuar nga sistemi elektronik i ndihmës ekonomike pasi kanë marrë pikë të pamjaftueshme, pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme për të jetuar dhe plotësojnë kriteret sipas detajimit në projektvndimin dhe relacionin që shoqëron projektvndimin.

Situata financiare:

Sipas dokumentacionit/relacionit qe shoqeron projekt vendimin

Drejtoria/Sektori përgjegjës:

Drejtoria e shërbimeve sociale

Drejtoria Ekonomise dhe menaxhimit financiar

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e shërbimeve sociale

Keshilli bashkiak Pogradec

Impakti social/grupet qe preken:

Qytetare te bashkise Pogradec

A është objekt i konsultimit publik? Jo.

Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik te Bashkise, Mbikëqyrjes Financiare, I Ekonomise Vendore, Turzimit dhe Zhvillimit Rural. Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin European, i mbledhur më datë 28.01. 2026, shqyrtoi projektvendimin **PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË FAMILJEVE NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDIN DERI NË 6% NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE PËR VITIN 2026**, Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojë Keshillit bashkiak:

- a- (Miratimin e projektaktit.
- b- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.
- c- Refuzimin e miratimit te projektaktit.
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes se komisionit.

Memora Shuli ; Gelmuk Haxhillari Kryetar i komisionit
Arben Hale Memora Shuli Sekretar i komisionit

Datë: 28.01. 2026